

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7179
E shtunë, 4 maj 2024
Çmimi 0.50

Kritika për pushtetin dhe mbështetje për lirinë e medieve në Kosovë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA SHËNON REGRES ALARMANT PËR 19 VENDE NË INDEKSNIN E REPORTERËVE PA KUFIJ

FAQE 4

REPORTERËT PA KUFIJ: GAZETARËT VAZHDOJNË TË JENË TARGET I SULMEVE POLITIKE



Publikimi i indeksit vjetor për lirinë e medias nga Reporterët Pa Kufij e rendit Kosovën në vendin e 75 në botë, 19 vende më poshtë sesa vitin e kaluar kur renditej në pozitën e

56. Organizata më e madhe botërore për lirinë e medias jep një sërë arsesh për përkeqësimin e lirisë së medias në vendin tonë. "Edhe pse media me sukses

vazhdon t'i mbajë politikanët përgjegjës, gazetarët vazhdojnë të jenë target i sulmeve politike", thuhet në raportin e Reporterëve pa Kufij

PETKOVICIT I NDALOHET VIZITA NË KOSOVË

F. 7



VENDOSJA E KAMERAVE TË SIGURISË NË VERI, ELSHANI: DO TË KRIJOJMË KLIMË TË SIGURISË MË TË MADHE TE QYTETARËT

F. 3



AKTUALE



FRANCA VLERËSON SE 150 000 USHTARË RUSË JANË VRARË NË UKRAINË

F. 2

PËRPARIM RAMA: SPITALI I KRYEQYTETIT PO BËHET

F. 3

25 VJET BURGIM PËR ENVER SEKIROQËN

F. 7

EKONOMI



DHOMA E TREGTISË DHE INDUSTRIË KËRKON NDRYSHIME URGJENTE NË KALENDARIN E FESTAVE ZYRTARE

F. 8

INPO: RRETH 463 KONTRATA NË VLERË RRETH 28 MILIONË EURO JANË LIDHUR PA QENË FARE TË PLANIFIKUARA

F. 8

SPORT



8 VJET NGA PRANIMI I KOSOVËS NË UEFA, ADEMI: ATY FILLOI NJË EPOKË E RE PËR FFK-në

F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Franca vlerëson se 150 000 ushtarë rusë janë vrarë në Ukrainë

PARIS, 3 MAJ - Franca vlerëson se 150 000 ushtarë rusë janë vrarë gjatë pushtimit të Ukrainës, të nisur nga Moskua, tha ministri i Jashtëm, Stephane Sejourne.

Në një intervistë për gazetën e pavarur "Novaya Gazeta Europe", Sejourne tha se, sipas vlerësimit të Parisit, numri i përgjithshëm i viktimave ruse gjatë luftës, përfshirë të plagosurit, është 500 000.

Pushtimi rus i Ukrainës tashmë ka hyrë në vitin e tretë. "Evropa dhe partnerët e saj do të vazhdojnë të jenë të bashkuar dhe të vendosur për aq kohë sa të jetë e nevojshme. Veçse është i dukshëm dështimi i ushtrisë ruse. Ne vlerësojmë se ushtria ruse ka humbje prej 500 000, përfshirë 150 000 të vdekur", tha ai. "E gjithë kjo për çfarë?", pyeti Sejourne. "E gjithë kjo mund të përmbledhet shkurt: për asgjë", tha ai.

Rusia nuk i ka bërë publike humbjet e pësuar gjatë luftës kundër Ukrainës.

Në muajin shkurt, presidenti

ukrainas Volodymyr Zelensky tha se 180.000 trupa ruse janë vrarë gjatë luftës.

Britania ka vlerësuar se afër 450 000 rusë janë vrarë ose plagosur në Ukrainë.

Në prill, transmetuesi publik britanik BBC ka raportuar se më shumë se 50 000 pjesëtarë të ushtrisë ruse kanë vdekur. Këtë shifër kjo media e ka bazuar në gazetaret e saj, vullnetarët dhe në grupin e pavarur medial "Mediazona".

Presidenti rus Vladimir Putin njoftoi për nisjen e "operacionit të posaçëm ushtarak" më 24 shkurt 2022 dhe, që atëherë, lufta është shndërruar në një mizori të përgjakshme që e ka izoluar Rusinë nga Perëndimi.

Disa analistë ushtarakë besojnë se Rusia mund të jetë në prag të nisjes së një ofensive të re të madhe në Ukrainë. "Novaya Gazeta Europe" u themelua nga gazetaret e gazetës kryesore të pavarur të Rosisë, "Novaya Gazeta", pak pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës.



Gjermania paralajmëron pasoja pas sulmit të dyshuar kibernetik rus



BERLIN, 3 MAJ - Rusia do të përballë me pasoja për sulmin kibernetik, që dyshohet se është orkestruar nga një grup që ka lidhje me inteligjencën ushtarake ruse, tha ministrja e Jashtëm e Gjermanisë, Annalena Baerbock. Gjermania është në mesin e shteteve perëndimore që i jep ndihmë ushtarake Ukrainës në luftën e saj me Rusinë.

Dhjetorin e kaluar presidenti rus Vladimir Putin tha se raportet në mes të Rosisë dhe Gjermanisë janë gjerësisht të ngrira. Në janar të vitit 2023, Berlini tha

se hakerët rusë kishin sulmuar disa uebfaqe gjermane, duke i nxjerrë nga përdorimi, në përgjigje të vendimit të Gjermanisë për të dërguar tanke në Ukrainë. Megjithatë, atëbotë autoritetet gjermane thanë se sulmi nuk kishte ndonjë efekt të ndjeshëm. "Tani ne qartësisht mund t'ia atribuojmë sulmin e vitit të kaluar grupit rus APT28, që kontrollohet nga shërbimi rus i inteligjencës ushtarake, GRU", tha Baerbock në një konferencë për medie në Adelaide më 3 maj. "Me fjalë të tjera, hakerët shtetërorë

rusë kanë sulmuar Gjermaninë në hapësirën kibernetike", shtoi Baerbock.

Kryediplotmatja gjermane e cilësoi si të papranueshëm një sulm të tillë dhe tha se ai "nuk do të mbetet pa pasoja".

Në mars, agjencia gjermane për siguri kibernetike dhe hulumtuesit që punojnë për Alphabet, të kompanisë Google, thanë se grupi i ngjashëm, i quajtur APT29, ishte kapur duke shënjestuar disa parti politike gjermane, me synimin që të vidheshin të dhënat e tyre.

Cameron në Kiev: Britania do ta ndihmojë Ukrainën sa të jetë e nevojshme

Kiev, 3 maj - Sekretari i Jashtëm i Britanisë së Madhe, David Cameron, ia ka premtuar të enjten Ukrainës 3.74 miliardë dollarë ndihmë vjetore ushtarake "sa të jetë e nevojshme".

Gjatë një vizite në Kiev të enjten, ai theksoi se Britania nuk është kundër që Ukraina t'i përdorë armët që ia dërgon Britania për sulme brenda Rosisë. "Ne do t'i japim tre miliardë funte çdo vit sa të jetë e nevojshme. Ne sapo kemi dhënë gjithçka që kemi sa iu përket pajisjeve", tha Cameron në një intervistë për "Reuters" gjatë vizitës në Kiev.

Pakojat prej tre miliardë funtash ndihmë ushtarake për Ukrainën

është më e madhja nga Britania deri tani, sipas tij. "Disa prej tyre [pajisjeve] janë duke mbërritur në Ukrainë sot, derisa unë po qëndroj këtu", shtoi ai.

Cameron tha se Ukraina ka të drejtë t'i përdorë armët që ia jep Londra për t'i goditur caqet brenda Rosisë, dhe se i takon Kievit të vendosë nëse dëshiron ta bëjë një gjë të tillë. "Ukraina e gëzon atë të drejtë. Sikurse Rusia që po sulmon brenda Ukrainës, mund ta kuptoni lehtë pse Ukraina e ndien nevojën për t'u siguruar se po e mbron veten", tha Cameroni.

Cameron, i cili e udhëhoqi Britaninë e Madhe nga viti 2010

deri në vitin 2016 si kryeministër dhe u rikthye në frontin e politikës pak muaj më parë, u takua me ministrin e Jashtëm të Ukrainës, Dmytro Kuleba, dhe me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky, gjatë vizitës së tij të dytë në Kiev si sekretar i Jashtëm.

Ai e përshëndeti miratimin e paketës së shumëpritur të ndihmës ushtarake amerikane për Ukrainën në vlerë 60 miliardë dollarë. "Kjo është tejet e rëndësishme jo vetëm për shkak të armëve që do t'i sjellë, por edhe për shkak se do ta rrisë moralin e popullit këtu në Ukrainë", nënvizoi ai.




QKUK-së i dhurohet një pajisje për trajtimin e kancerit të gjirit

PRISHTINË, 3 MAJ - Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka njoftuar se me iniciativën e fondacionit që ajo drejton, është siguruar pajisja "Sentinel Node" për Klinikën e Kirurgjisë Torakale në QKUK. "Pas inaugurimit të pajisjes SPECT/PET/CT në Mjekësinë Nukleare, në partneritet me Medica, sot dhuruam pajisjen Sentinel Node në Klinikën e Kirurgjisë

Torakale. Vitet e fundit ka rritje të konsiderueshme të rasteve të kancerit në vend dhe gjithë botën. Andaj dhurimi i kësaj pajisje të avancuar do ta përmirësojë padyshim saktësinë e ndërhyrjeve, do ta minimizojë kohën e shërimit dhe do t'i përmirësojë rezultatet e përgjithshëm të pacientëve, veçanërisht në diagnostikimin dhe trajtimin

e kancerit të gjirit dhe melanomës. Ky donacion, si vazhdimësi e donacionit për Spitalin Pediatrik, Mamografit në k0omunën e Kamenicës, SPECT/PET/CT, dëshmon përkushtimin tim të palëkundur dhe të Fondacionit 'Jahjaga' ndaj shëndetit publik dhe mirëqenies së qytetarëve tanë", ka njoftuar Jahjaga në "Facebook".



Vendosja e kamerave të sigurisë në veri, Elshani: Do të krijojmë një klimë të sigurisë më të madhe te qytetarët

PRISHTINË, 3 MAJ - Në katër komunat veriore të Kosovës është duke u vendosur sistemi i vëzhgimit me kamerë.

Zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës së Veriut, Veton Elshani, në një intervistë për "Telegrafi"-n ka treguar se sa e rëndësishme është vendosja e sistemit të vëzhgimit në katër komunat veriore të Kosovës.

Elshani tha se vendosja e kamerave ka filluar që një kohë më të gjatë në veri të vendit. Ai tha se aty ku ka pikë statike dhe ku qëndrojnë pjesëtarët e Policisë së Kosovës, aty do të ketë dhe kamera të sigurisë. "Prej momentit që kemi ardhur këtu në dhjetor të vitit 2022, ne e kemi pasur për obligim t'i mbrojmë stacionet policore dhe pikat ku rri policia. Aty ku ka pikë statike, aty ku është policia, ka dhe kamera. Sidoqoftë tani jemi zgjeruar duke marrë më shumë policë në detyrë. Jemi zgjeruar në kualitet të

hetimeve dhe e kemi të arsyeshme dhe kemi bërë kërkesë që të vendosen kamera në mbarë territorin e veriut të vendit, nëpër rrugë magjistrale, e rrugë komunale si në Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok", ka thënë Elshani. Sipas tij, ky proces tashmë ka filluar dhe konsideron se do të varet edhe nga kompania se deri kur mund t'i kryejë këto punë me instalime. Elshani tregoi se rreth 200 kamera do të vendosen në katër komunat veriore: "Veriu i vendit nuk ka asnjë dallim nga rajoni i Pejës apo i Gjilanit etj. Por, vendosja e kamerave të sigurisë, sipas ligjit, arsyetohet me atë që vendet publike mbulohehen dhe qëllimin kryesorë e kanë parandalimin e kundërvajtjeve, të veprave penale. Por nëse ato ndodhin të kemi kualitet të hetimeve. Që d.m.th të kemi më lehtë ndriçimin e rasteve".

I pyetur se sa ua lehtëson punën në terren vendosja e sistemit të



vëzhgimit, Elshani tha: "Na e lehtëson shumë punën. Që d.m.th e kemi mundësinë që nëpërmjet monitorimit të

kamerave t'i verifikojmë rrugët magjistrale, qytetin, apo udhëkryqet, që aty gjithsesi kalojnë kryerësit e veprave penale

apo kundërvajtësit, etj. Do të krijojmë një klimë të sigurisë më të madhe te qytetarët e veriut të vendit".



Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e qendrës për qëndrim ditor për personat e moshuar në Gjilan

GJILAN, 3 MAJ - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim kryetarin e Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati. Ata kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për ndërtimin e qendrës për qëndrim ditor për personat e moshuar, e cila kap

vlerën mbi 3.5 milionë euro. Më tej i pari i Gjilanit bëri me dije se Halil Kastrati nga shoqata "Jetimat e Ballkanit" dhe komuna e Gjilanit në bashkëpunim do ta ndërtojnë qëndrimin ditor për të moshuarit, kuzhinën popullore dhe bujtinën për studentë.

"Bashkë për të mirën e përgjithshme", ka thënë Hyseni. Ndërsa Halil Kastrati tha se lajmi për kuzhinën është i gëzueshëm. "Kjo është kuzhina e tretë që po bëhet dhe kjo është e rëndësishme. Qendra të tilla do të ndërtohen në tërë Kosovën", ka thënë Kastrati.

Përparim Rama: Spitali i kryeqytetit po bëhet

PRISHTINË, 3 MAJ - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se spitali i kryeqytetit po bëhet. Ai ka thënë të premten

se tashme kanë diskutuar për detajet finale të projektit të spitalit të kryeqytetit. "Një projekt i shumëpritur që do ta bëjë më të lehtë qasjen në

shërbimet shëndetësore dytësore për qytetarët e Prishtinës. Kardiologji, pediatri, gjinekologji e shumë reparte të tjera me kushte dhe

standarde të nivelit evropian. Shumë shpejt projekti do të tenderohet dhe do të fillojë ndërtimi", ka shkruar Rama në "Facebook".





KOSOVA SHËNON REGRES ALARMANT PËR 19 VENDE NË INDEKSIN E REPORTERËVE PA KUFIJ

Reporterët pa Kufij: Gazetarët vazhdojnë të jenë target i sulmeve politike

Publikimi i indeksit vjetor për lirinë e medias nga Reporterët Pa Kufij e rendit Kosovën në vendin e 75 në botë, 19 vende më poshtë sesa vitin e kaluar kur renditej në pozitën e 56. Organizata më e madhe botërore për lirinë e medias jep një sërë arsyesh për përkeqësimin e lirisë së medias në vendin tonë. “Edhe pse media me sukses vazhdon t’i mbajë politikanët përgjegjës, gazetarët vazhdojnë të jenë target i sulmeve politike”, thuhet në raportin e Reporterëve pa Kufij

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MAJ - Kosova ka rënë për 19 vende në Indeksin vjetor për lirinë e shtypit të organizatës Reporterët pa Kufij, përkatësisht këtë vit renditet në vendin e 75 në botë nga 180 shtete, për dallim nga viti i kaluar që ishte në vendin e 56. Në raportin e publikuar nga Reporterët pa Kufij më 3 maj, në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, thuhet se mediet në Kosovë, pavarësisht se vazhdojnë t’i mbajnë përgjegjës politikanët, gazetarët vazhdojnë të jenë “cak i sulmeve politike”. “Edhe pse media me sukses vazhdon t’i mbajë politikanët përgjegjës, gazetarët vazhdojnë të jenë target i sulmeve politike.

Rregullatori i joefikas i medieve, Komisioni i Pavarur i Medieve [KPM], po provon ta reformojë veten. Televizioni më i madh, Klan Kosova, ka qenë subjekt i sulmeve administrative nga qeveria, e cila, gjithashtu, e ka kërcënuar pavarësinë e transmetuesit publik, RTK, me zgjedhjen e një aleati të afërt të partisë në pushtet në postin e drejtorit. Mediet në gjuhën serbe, që janë nën presion nga forcat politike serbe, janë ankuar për diskriminim në qasje në informatat publike, sidomos në gjuhën e tyre, që është e drejtë kushtetuese për minoritetet”, thuhet në raportin e Reporterëve pa Kufij. Në raport thuhet se gjatë vitit gazetarët në Kosovë kanë qenë cak i sulmeve fizike dhe “rrjetet kriminale kanë penguar punën

e tyre”.

Në raport thuhet se janë rritur paditë SLAPP [padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike] ndaj gazetarëve. “Edhe pse sulmet po hetohen nga policia dhe prokuroria, rastet rrallë ndiqen penalisht. Sulmet ndaj gazetarëve janë rritur në kohën e tensioneve politike në mes të Prishtinës dhe Beogradit”, thuhet në raport.

Gazetarët kanë qenë cak i sulmeve fizike gjatë raportimeve të tyre majin e vitit të kaluar në veri të Kosovës, kur u rritën tensionet në këtë zonë të banuar me shumicë serbe. Në raportin e Reporterëve pa Kufij u tha se mediet në Kosovë janë të varura nga reklamat qoftë “nga qeveria apo nga partitë politike”. “Për më tepër, përmes pronarëve të tyre, mediet private janë të ekspozuara nga ndikimi i grupeve të fuqishme politike apo biznesore. Mediet në gjuhën serbe përballen me sfida edhe më të mëdha në tregun e vogël, ku disa media varen nga financimi që vjen nga Serbia fqinje, ndërkajq mediet e pavarura nuk mund të mbijetojnë pa financim ndërkombëtar”.

Edhe shtetet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë shënuar kthim prapa sa i përket

lirisë së medias. Sa i përket Serbisë, në raport thuhet se ky shtet renditet në vendin e 98, krahasuar me një vit më parë kur ishte në vendin e 91-të. “Në një klimë politike që gjithnjë e më shumë u bë polarizuese për shkak të protestave antiqeveritare më 2023, gazetarët shpesh ishin cak i sulmeve nga anëtarët e elitës udhëheqëse, që u amplifikuan nga disa kanale televizive ndërkombëtare”, u tha në raport, ku u shtua se rregullatori i medieve elektronike në Serbi, anëtarët e të cilit kryesisht emërohen nga qeveria, “nuk kanë qenë të gatshëm ta korrigjojnë situatën”. Sipas Indeksit, edhe Shqipëria ka rënë nga vendi i 96 në atë 99.

Në Shqipëri, sipas Reporterëve pa Kufij, gazetarët përballen me presion politik, veçmas gjatë zgjedhjeve. “Gazetarët kritikë shpesh janë subjekt i sulmeve që synojnë diskreditimin e tyre si nga qeveria ashtu edhe opozita, dhe ata e kanë të vështirë të kenë qasje në informacione publike”, u tha në raport.

Edhe tri shtetet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë bërë kthim prapa sa i përket lirisë së medieve, sipas indeksit të Reporterëve pa Kufij. Maqedonia e Veriut nga vendi 36 sa ishte vitin e kaluar, këtë vit është në vendin e 38. Bosnjë-Hercegovina nga pozita 64, tani është në 81, ndërkajq Mali i Zi ka rënë për një vend, nga 39 në 40.

Indeksi i lirisë së shtypit: Renditja e Kosovës ndër vite

Kosova ka shënuar regres sa i përket lirisë së medieve sipas organizatës joqeveritare Reporterët pa Kufij. Në Indeksin e saj Botëror të Lirisë së Shtypit për vitin

2024, Kosova renditet e 75-ta nga 180 shtete, apo 19 vende më poshtë sesa në vitin paraprak, kur mori vlerësimin më të mirë në një dekadë e gjysmë.

Kritika për pushtetin dhe mbështetje për lirinë e medieeve në Kosovë



PRISHTINË, 3 MAJ - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka shprehur mbështetjen për gazetarët dhe për mbrojtjen e të drejtës së tyre për të raportuar pa frikë e pa censurë në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit. Ndërkaq partitë opozitare kanë kritikuar qeverinë për sulm ndaj medieeve.

Reagimet e tyre vijnë pas publikimit të Indeksit për Liri të Shtypit nga organizata joqeveritare Reporterët pa Kufij, ku Kosova u rendit në vendin e 75-të, apo 19 vende më poshtë sesa në vitin paraprak.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se liria e shtypit është thelbësore për demokracinë dhe të vërtetën. Megjithatë, ajo shprehu shqetësim për lajmet e rreme dhe dezinformatat dhe tha se luftimi i tyre "nuk ka qenë kurrë më urgjente".

"Këtë betejë duhet ta bëjmë bashkë, institucionet, gazetaret dhe shoqëria civile, ngase vetëm bashkërisht mund ta mirëmbajmë një ambient ku e

vërteta mbizotëron ndaj lajmeve të rreme dhe ku media është e lirë ta përmbushë rolin e saj si mbrojtëse e demokracisë dhe e të drejtës së qytetarëve për të qenë të mirinformuar", tha Osmani përmes një deklaratë për medie.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, tha se raporti i Reporterëve pa Kufij nuk duhet të jetë dekurajues, pasi ka argumentuar se nuk ka qenë vit i lehtë për shkak të përshkallëzimit të situatës në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe.

Dy çështjet kyçe, sipas tij, që kanë diktuar renditjen e Kosovës në indeks, janë protestat në veri, ku ka pasur sulme ndaj gazetarëve që, sipas Kryeziut, janë kryer nga "bandat kriminale të strukturave paralele të Serbisë" dhe për çështjen e Klan Kosovës që, sipas tij, kjo media është "regjistruar në Kosovë me dokumente të Serbisë" dhe llogaridhënia që i është kërkuar nga institucionet në raport

është përshkruar si: "Klan Kosova ka qenë subjekt i ngacmimeve administrative nga Qeveria e Kosovës", ka shkruar Kryeziu në "Facebook".

Për gjendjen e lirisë së medieeve kanë reaguar edhe partitë opozitare shqiptare në Kuvendin e Kosovës, të cilat e kanë kritikuar pushtetin për sulm të medieeve.

Kreu i subjektit më të madh opozitar, Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, tha se historikisht punëtorët mediaë kanë "mirëmbajtur standarde, integritetit dhe guxim të lartë edhe në kohët më të errëta të vendit tonë". "Prandaj, zhvillimet e fundit në Kosovë, megjithëse në liri, paraqesin një pamje dhe një situatë tejet shqetësuese për median e lirë", shkroi ai në "Facebook".

Duke folur për kthimin prapa që ka bërë Kosova në Indeksin e Reporterëve pa Kufij, Krasniqi tha se "presioni në rritje i qeverisë ndaj medieeve të pavarura dhe shënjestrimi i gazetarëve të vendit tonë është

kërcënim në rritje për lirinë e shtypit dhe fjalës së lirë".

Reporterët pa Kufij thanë se mediet në Kosovë, pavarësisht se vazhdojnë t'i mbajnë përgjegjës politikanët, gazetaret vazhdojnë të jenë "cak i sulmeve politike". "I bëj thirrje qeverisë ta ndërpresë cenimin dhe përndjekjen e gazetarëve dhe medieeve të lira të vendit tonë. Gazetarët duhet të vazhdojnë të punojnë pa frikën e hakmarrjes, censurës ose persekutimit", tha Krasniqi.

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës shprehi shqetësim për gjetjet e raportit të Reporterëve pa Kufij, por edhe të dy raporteve të publikuara së fundi nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe organizata për të drejtat e njeriut, Freedom House, ku janë përmendur kufizimet ndaj lirisë së shprehjes dhe medieeve.

"Lidhja Demokratike e Kosovës e sheh alarmuese këtë raport [të Reporterëve pa Kufij], i cili flet për ambientin tejet shqetësues të të bërit gazetari në Kosovë.

Sepse, sot në këtë ditë botërore duhet të kujtojmë dhe vlerësojmë rëndësinë jetike të një shtypi të lirë dhe të pavarur, që është themeli i çdo demokracie të shëndetshme. Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson po ashtu se demokracia nuk mund të mbijetojë në heshtje. Për një shoqëri që dëshiron të avancojë, duhet një media e lirë që sfidon, pyet dhe kërkon llogari", u tha në reagimin e LDK-së.

Ndërkaq, kreu i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se mbrojtja e gazetarëve dhe medieeve të lira është ndër "parimet e panegociueshme" dhe detyrë e institucioneve dhe shoqërisë. "Shqetësues mbetet qasja e eksponentëve të pushtetit me sulmet e orkestruara që i bëjnë mediave dhe tendenca për kontroll ndaj tyre, duke shënuar regres alarmant sa i përket lirisë së medias, i vërtetuar edhe nga raportet e institucioneve kredibile ndërkombëtare", shkroi Haradinaj në "Facebook".

Bulliçi i jep mirënjohje togeres Antigona Çitaku-Dibrani

PODUJEVË, 3 MAJ - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliçi, i ka dhënë mirënjohje togeres Antigona Çitaku-Dibrani, e cila para pak ditësh ka fituar çmimin ndërkombëtar për shërbim në

komunitet nga Asociacioni Ndërkombëtar i Grave Police. Kryetari e përgëzoi Çitakun për çmimin e fituar dhe kontributin e vazhdueshëm në rendin dhe sigurinë publike në qytetin e Podujevës, duke u

zotuar se do ta mbështesë dhe do ta vazhdojë bashkëpunimin e shkëlqyer me Stacionin Policor në Podujevë. Ndërsa Togerja Çitaku falënderoi kryetarin Bulliçi për

mirënjohjen, vlerësimin dhe mbështetjen e vazhdueshme. Në takim ajo shoqërohej nga Komandanti i Stacionit Policor, Bashkim Bajrami dhe zëvendëskomandantja Valbona Blakçori.



Në Drenas vihet gurthemeli për energji të ripërtërishme me vlerë mbi 43 milionë euro



DRENAS, 3 MAJ - Kompania prestigjioze "Yldirim" ka vënë gurthemelin e projektit të energjisë së ripërtërishme, me panele solare, me kapacitet 54 megavate. Në këtë inaugurim, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, është shprehur shumë i lumtur, duke e quajtur ditë të rëndësishme për komunën e Drenasit dhe Kosovën. "Projekti ka kapacitet 54 megavate dhe vlerë mbi 43 milionë euro në fazën e parë, me synimin e ngritjes së fuqisë prodhuese të energjisë në 300 megavate. Sot për komunën e Drenasit dhe Kosovën po hapet një rrugë e re, me perspektivë, sepse kompania prestigjioze "Yldirim" - pronare e Feroniklit, e cila operon në 9 industri, 5

kontinente, në 57 shtete, po e zgjeron veprimtarinë e vet në fushën e energjisë. Ky sukses gëzon çdo qytetar të Drenasit dhe të Kosovës, duke e rritur imazhin prosperues të komunës dhe të shtetit tonë", ka thënë Lladrovci. Ai ka thënë se i ka siguruar investitorët se do të jenë bashkëpunues në këtë drejtim. "Ky investim i madh për energjinë e ripërtërishme i kompanisë "Yldirim", brenda kompleksit industrial Feronikli, është dëshmi e klimës pozitive për biznes dhe bashkëpunimin tonë të shkëlqyer, duke dëshmuar sikur deri sot se komuna e Drenasit dhe Kosova janë shembull të mikpritjes dhe klimës për të bërë biznes", është shprehur Lladrovci.

Realizohet platforma digjitale për fermerët e komunës së Gjilanit

GJILAN, 3 MAJ - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni dhe rektori i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, Artan Dërmaku, kanë bërë pranim-dorëzimin e projektit Platforma Digjitale për fermerët e komunës së Gjilanit.

I pari i komunës tha se ka përfunduar projekti i digjitalizimit për sektorin e bujqësisë nga Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan.

Kryetari tregoi se në ceremoninë e organizuar nga UKZ rektori Artan Dërmaku dorëzoi projektin. "Ky bashkëpunim ishte mundësi për studentët dhe stafin akademik që ta jetësojnë platformën", ka thënë Hyseni.

Më tutje, kryetari i Gjilanit shtoi se tani e tutje Platforma për Bujqësinë do t'i lehtësojë shërbimet si dhe do të mundësojë vendimmarrje të bazuar në të dhëna për institucionet lokale.



Ndërsa rektori i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, Artan Dërmaku, shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin e suksesshëm mes universitetit dhe komunës në këtë projekt

inovativ. "Përgëzoj studentët për punën e palodhshme dhe për talentin e tyre që kanë treguar se kanë potencial për të ndryshuar për të mirën në komunitetet e komunës", ka thënë Dërmaku.

Hapet Festivali Folklorik 'Hasi Jehon 2024'

PRIZREN, 3 MAJ - Për disa dekada ky festival mbetet vendtakim kulturor dhe artistik i shoqërive tona kulturore e artistike, që mbahet me 2, 3 dhe 4 maj në Kodrën e Pajtimit në fshatit Gjonaj në Prizren.

Në hapjen solemne mori pjesë edhe kryeministri Albin Kurti, përfaqësues të shoqërive kulturo-artistike nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali Zi, nga mërgata dhe artdashës.

Kryeministri në fjalën e tij hapëse tha se "Hasi Jehon" ka sfiduar

vështrirësitë dhe është forcuar nga aspekti i cilësisë, duke bërë kështu që ta marrë epitetin e një prej festivaleve më të rëndësishme të folklorit burimor të trojeve ku jetojnë shqiptarët.

Teksa foli për ngritjen e kapaciteteve për mbështetjet financiare nga Qeveria e Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ai premtoi përkrahje në mënyrë të vazhdueshme për ansambletë, projektet e veçanta, studimet, botimet e aktivitetet e ndryshme në të gjithë Kosovën, në nivelin qendror dhe atë lokal.



Hapet dyqani i parë social në Prishtinë

PRISHTINË, 3 MAJ - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije të premtën se është hapur dyqani i parë social në kryeqytet. Rama ka thënë se qytetarët në nevojë tani e tutje mund të furnizohen në këtë dyqan

çdo muaj, falas, me produkte ushqimore dhe higjienike. "Hapëm dyqanin e parë social në kryeqytet. Qytetarët në nevojë tani e tutje mund të furnizohen në këtë dyqan çdo muaj, falas, me produkte ushqimore e

higjienike. Me hapjen e këtij dyqani, bashkë me Shoqatën Humanitare Bamirëse "Bereqeti", po shprehim vullnetin tonë të vazhdojmë t'i mbështesim nevojat themelore të qytetarëve tanë", ka shkruar Rama në "Facebook".



Petkoviqit i ndalohet vizita në Kosovë

PRISHTINË, 3 MAJ - Shefi i Zyrës për Kosovën në qeverinë serbe, Petar Petkoviq, tha se autoritetet në Kosovë ia kanë refuzuar kërkesën të zhvillojë vizitë në Kosovë për Pashkët Ortodokse gjatë fundjavës.

Sipas një njoftimi të kësaj zyre, Petkoviqi gjatë kësaj vizite ishte paraparë të merrte pjesë në liturgjinë e mesnatës për Pashkët në Manastirin e Deçanit, pastaj në shërbesën në Manastirin e Graçanicës në mëngjesin e Pashkëve dhe në një takim me të rinjtë në Manastirin e Draganacit. "Ndonëse vizita ishte ekskluzivisht e karakterit fetar dhe përfshinte ekskluzivisht vizita në manastire dhe në vendet e shenjta të Kishës Ortodokse Serbe, në frymën e festës më të madhe për serbët, pa qëllime politike, autoritetet në Prishtinë e ndaluan vizitën e tij pa asnjë shpjegim", tha Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.

Kjo zyrë tha se për më shumë se

një vit qeveria e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, po e pengon Petkoviqin t'i vizitojë serbët në Kosovë. "Këto ndalime [të vizitave] jo që janë të pabaza, por paraqesin edhe shkelje të drejtpërdrejta të Marrëveshjes për lëvizjen e lirë dhe për vizita zyrtare, veçmas kur bëhet fjalë për kryenegociatorin në dialog nga pala serbe".

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës ende nuk është përgjigjur në pyetjen dërguar nga "Radio Evropa e Lirë" për ta konfirmuar ose për të hedhur poshtë njoftimin e palës serbe.

Në të kaluarën Kosova ka refuzuar kërkesat e parashtruara nga Petkoviqi për të zhvilluar vizita, duke thënë se refuzimi ishte për shkak të "deklaratave provokuese".

Ndërkaq, në janar të këtij viti, Serbia ia refuzoi kërkesën për vizitë ministrit të Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla. Ai kishte planifikuar t'i



vizitonte komunat Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc, që janë të banuara me shqiptarë.

Çështja e vizitave zyrtare në mes të Kosovës dhe Serbisë rregullohet

përmes një marrëveshjeje të arritur në kuadër të dialogut për normalizim të raporteve që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Këto vizita duhet të

paralajmërohen përmes zyrtarëve ndërlidhës të Kosovës dhe të Serbisë. Ndërkaq, autoritetet e shteteve përkatëse duhet t'i autorizojnë ato.

Zbuloni të ardhmen e ekonomisë në Expokos 2024: Hapja e dyerve për inovacion dhe mundësi

PRISHTINË, 3 MAJ - Ndërsa pritja rritet dhe emocionet mbushin ajrin, ju njoftojmë se edicioni i shumëpritur i 23-të i Panairit Expokos do t'i hapë dyert për publikun më 15 maj 2024, për dy ditë të pashoqe eksplorimi dhe zbulimi.

Expokos, i njohur si ngjarja kryesore promovuese në rajonin e Ballkanit Perëndimor, fton vizitorët të nisnin një udhëtim në të ardhmen e ekonomisë. Nga data 15 deri në 16 maj të pranishmit do të kenë mundësinë ekskluzive për t'u zhytur në një botë inovacioni, bashkëpunimi dhe ideve transformuese.

I shtrirë nëpër hapësirat pranë dhe në sallën 1 Tetori në Prishtinë, Expokos 2024 do t'i shfaqë avancimet dhe tendencat më të fundit në sektorët e Ndërtimit, Energjisë, Minierave, Mbrojtjes dhe Sigurisë. Me mbi 23 vjet përsosmëri, kjo ngjarje prestigjioze vazhdon të shërbejë si një platformë e rëndësishme për bizneset që të lidhen, të



angazhohen dhe të lulëzojnë. Këtë vit Expokos bën një hap përpara me temën e "E ardhmja e ekonomisë", duke u fokusuar në çështje aktuale si praktikat e qëndrueshme, inovacioni i

gjelbër, transformimi digjital dhe fuqizimi i fuqisë punëtore. Npërmjet sesioneve informative, ekspozitave tërheqëse dhe prezantimeve dinamike, vizitorët do të ftojnë

njohuri të paçmueshme për sfidat dhe mundësitë që formojnë ekonominë e së nesërme.

Për më tepër, panairi premtion një linjë dinamike të aktiviteteve

paralele, duke përfshirë prezantime nga institucionet dhe ekspozim nga anëtarët e shoqatave si Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Klubi i Biznesit Slloven, Oda Ekonomike Britaneze në Kosovë dhe Oda e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës. Këto sesione do të ofrojnë perspektiva unike mbi bashkëpunimin ndërkombëtar, partneritetet ekonomike dhe rrugën drejt prosperitetit.

Expokos 2024 nuk është thjesht një panair; është një përvojë që kapërcen kufijtë, nxit lidhjet dhe ndez frymëzimin. Pavarësisht nëse jeni një profesionist me përvojë në industri, një sipërmarrës aspirues ose thjesht kurioz për të ardhmen e biznesit, ka diçka për të gjithë në Expokos. Mos e humbisni mundësinë për t'u bërë pjesë e këtij eventi të jashtëzakonshëm. Shënoni në kalendarët tuaj datat 15 dhe 16 maj dhe bashkohuni me ne derisa hartojmë një rrugë drejt një të ardhme më të ndritshme dhe më të qëndrueshme.

25 vjet burgim për Enver Sekiraqën

PRISHTINË, 3 MAJ - Gjykata e ka dënuar Enver Sekiraqën me 25 vjet burgim për nxitje në vrasjen e policit Triumf Riza. Aktgjykimi në fjalë u shpall nga gjykatësi Agim Kuçi, raporton "Betimi për Drejtësi". Sipas gjykatësit Kuçi, Sekiraqës do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak.

I akuzuari Sekiraqa detyrohet t'i paguajë shpenzimet

procedurale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, për paushall gjyqësor shumë prej 200 eurosh dhe 50 euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar u udhëzua në kontest të rregullt juridiko-civil, ndërsa palët e pakënaqura

kundër këtij aktgjykimi kanë të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit.

Të akuzuarit Sekiraqa, me aktvendim të veçantë, iu ndërpre masa e arrestit shtëpiak. Sipas gjykatësit Kuçi, një arsyetim më i detajuar lidhur me këtë çështje do të jepet me rastin e përpilimit të aktgjykimit.



Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë kërkon ndryshime urgjente në kalendarin e festave zyrtare

PRISHTINË, 3 MAJ - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë (DHTIK) kërkon nga kryeministri dhe Qeveria e Kosovës që me urgjencë të propozojnë ndryshimplotësimin e Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës në mënyrë që të veprojmë ashtu siç veprojnë çdo vend evropian. "Praktika e deritanishme që ditët e festave që bien në ditë vikendi, të zëvendësohen me pushim gjatë ditëve të punës, përkatesisht Neni 4 i Ligjit për Festat Zyrtare, sipas të cilit, 'Kur ditët e festave

zyrtare të cekura në nenin 2 të këtij ligji bien ditën e shtunë ose të diel, ditë pushimi do të jenë ditët pasardhëse të punës', është praktikë e cila ka dëmton vendin jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në aspektin e reputacionit ndërkombëtar, sepse asnjë vend tjetër nuk e zëvendëson pushimin në një datë tjetër", është thënë në reagimin e Dhomës së Tregtisë.

DHTIK-ja kërkon që festat zyrtare të mos zëvendësohen me ditë punë në rastet kur

ato bien gjatë fundjavës, por ditë pushimi të jetë vetëm dita e cila është ditë pushimi. "Gjithashtu, DHTIK kërkon që të festohen, por mos të jenë ditë pushimi, ditët: 9 Prilli, Dita e Kushtetutës dhe 9 Maji Dita e Evropës. DHTIK kërkon, po ashtu, që festat e komuniteteve të jenë ditë pushimi për këto kategori, por jo edhe për gjithë vendin. DHTIK mbetet me shpresë se këto rekomandime do të merren parasysh në mënyrë që të kontribuohet në rritjen e ditëve të punës dhe rritjen e ardhjes së investimeve nga



Evropa aq shumë të nevojshme për vendin tonë me papunësinë më të madhe në Evropë dhe me të

ardhurat më të vogla për kokë banori në Evropë", është thënë në reagimin e Dhomës së Tregtisë.

INPO: Rreth 463 kontrata në vlerë rreth 28 milionë euro janë lidhur pa qenë fare të planifikuara

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MAJ - Organizata Iniciativa për Progres (INPO), me mbështetje të Rockefeller Brothers Fund, të premten në një konferencë për medie ka publikuar raportin me titull "Performanca e Qeverisë së Republikës së Kosovës në realizimin e prokurimit".

Albulena Nrecaj-Musliu, drejtoreshë ekzekutive në Iniciativa për Progres (INPO), ka theksuar se raporti përfshin monitorimin e ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit dhe pasqyron se sa i përmbahen planifikimit përfundimtar të prokurimit, ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit, gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, respektivisht sa dhe çfarë kontrata kanë planifikuar, sa është vlera e tyre e planifikuar dhe çfarë kanë kontraktuar në realitet.

Nrecaj-Musliu ka thënë se përmbushja e objektivave në mënyrë efikase dhe në ofrimin e shërbimeve cilësore e determinon edhe një planifikim i mirë i prokurimit, i cili, po ashtu, siguron që edhe fazat e tjera të prokurimit, siç janë tenderimi dhe menaxhimi i kontratës, të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, sigurisht edhe ta garantojnë ruajtjen e vlerës për



paranë publike.

Monitoruesi në INPO, Arber Kabashi, ka paraqitur gjetjet dhe rekomandimet e raportit. Ai ka thënë se gjetjet tregojnë se Qeveria e Republikës së Kosovës (ministrinë dhe zyra e kryeministrit) gjatë vitit 2023 kanë planifikuar të prokurim të gjithsej 935 aktivitete të prokurimit, 378 për furnizime, 314 për shërbime, 239 punë dhe 4 konkurse të

projektimit. "Bazuar në raportet vjetore të kontratave të nënshkruara, vërejmë se në total gjatë vitit 2023 këto institucione kanë realizuar gjithsej 336 aktivitete të prokurimit, të cilat kanë rezultuar me 489 kontrata. Ndërkaq, gjatë vitit 2023, gjithsej janë nënshkruar nga këto institucione 952 kontrata", ka thënë ai.

Kabashi ka theksuar se rreth 463

kontrata apo gjysma e kontratave në vlerë rreth 28 milionë euro janë lidhur pa qenë fare të planifikuara. Vetëm një numër i vogël i tyre kanë të justifikuar procedurën e inicimit pa planifikim.

Në fund u dhanë këto rekomandime kryesore: Ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit të kujdesen që planifikimin vjetor të prokurimit ta bëjnë përkritazi me objektivat e

tyre institucionale dhe procesi i vlerësimit të nevojave të bëhet mbi bazën e indikatorëve matës dhe efikas, në mënyrë që tenderimi i kontratave të jetë i bazuar në planifikim efikas dhe efektiv.

Ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit ta ndalojnë praktikën e lidhjes së kontratave të paplanifikuara.

Ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit ta bëjnë analizën e tregut, e cila, përveç të tjerash, u mundëson parashikimin e vlerës së kontratës bazuar në çmimet e tregut. Kjo ndikon edhe në një planifikim dhe menaxhim më të mirë të buxhetit të tyre.

Ministria e Arsimit të sigurohet se tenderët për ndërtimin e çerdheve të kalojnë të gjitha fazat e planifikimit jo vetëm të prokurimit, por edhe atyre të lokacionit dhe të sigurohet që në të ardhmen të mos planifikojë tender për të cilët ekzistojnë pengesa për t'u inicuar.

Ministria e Mbrojtjes në raportet e kontratave të nënshkruara të paraqesë edhe vlerën e indikative të kontratës jo vetëm çmimet për njësi.

MAPL të mos planifikojë tenderë në planin e saj të prokurimit, të cilët derivojnë nga granti i performancës për komunat fituese të grantit.

Vazhdon trendi rritës i të hyrave tatimore, 356.5 milionë euro vetëm për periudhën janar - prill

PRISHTINË, 3 MAJ - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se po vazhdon trendin rritës të të hyrave. Vetëm për periudhën janar - prill 2024 ka arritur të mbledhë 356.5 milionë euro, apo 38.9 milionë euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shprehur në përqindje 12.3%. Në raport me planin, ka tejkalim të planit për 7.9 milionë euro apo 2.3%.

ATK-ja ka njoftuar se përmbushja vullnetare e obligimeve tatimore vazhdon të mbetet prioritet kryesor, duke u siguruar që tatimpaguesit ta paguajnë shumën e saktë tatimore dhe duke ndërmarrë veprimet e duhura ligjore ndaj t a t i m p a g u e s v e mospërmbushës. "Reformat e realizuara vitet e fundit, ofrimi i shërbimeve ndaj tatimpaguesve, rritja e

përgjegjësisë dhe llogaridhënies, janë disa nga faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të hyrave. ATK u bënë thirrje të gjithë tatimpaguesve që t'i kryejnë obligimet tatimore në mënyrë që mos të bëhen objekt i gjobave dhe ndëshkimeve të parapara me ligj, gjithashtu falënderon të gjithë tatimpaguesit të cilët i kryejnë saktë dhe me kohë obligimet tatimore", ka njoftuar ATK-ja.



Njeriu që po zbulon 'pandeminë e ardhshme'



Nga Oriol GÜELL, El Pais

Një dekadë më parë, Zhan-Mishel Klaverje, 73 vjeç, shkriu një gram permafrost – tokë në ngricë të përherëshme në Arktik – duke arritur të ringjallte një virus 30.000-vjeçar dhe të dhe infektonte me të një amebë. Ishte një moment historik në një karrierë gjatë së cilës ai ka zbuluar së fundmi pesë familje të reja virusesh, të quajtura gjithashtu "viruse zombie", në mostrat deri në 48.500-vjeçare vjetra të marra nga shtatë zona të ndryshme në Siberi.

Me ndryshimet klimatike dhe temperaturat që në Arktik po rriten më shpejt se sa në pjesën tjetër të planetit, profesori i gjenetikës në Universitetin e Marsejës në Francë, mendon se ka ardhur koha të ndalojmë së konsideruari këto lloj gjetjesh si një kuriozitet shkencor dhe t'i trajtojmë ato si një "kërcënim për shëndetin publik".

Klaverje i ndau së fundmi njohuritë e tij me 18.000 specialistë të mbledhur në Barcelonë në Kongresin e Shoqatës Evropiane të Mikrobiologjisë Klinike dhe Sëmundjeve Infektive (ESCMID Global), më i madhi në botë i këtij lloji.

Një pandemi e shkaktuar nga një virus që çlirohet nga akulli. Është e frikshme, por është e vështirë të besohet, apo jo?

Është më mirë të hetohen,

njihen rreziqet dhe të merren masa për t'i minimizuar ato. Tre janë faktorët kyç: i pari, ka viruse që nuk i njohim dhe që gjenden në permafrost. Së dyti, temperaturat në rritje po shkrijnë gjithnjë e më shumë tokë të ngrirë. Dhe së treti, po shtohet numri i njerëzve që lëvizin nëpër këto zona.

Kjo do të thotë se ka më shumë shanse që të ndodhë diçka, apo jo?

Po. Dhe kujtoni pak se çfarë ndodhi me popullsinë e Amerikës, kur evropianët zbarkuan atje bashkë me sëmundjet e tyre. Nëse njerëzimi do të binte në kontakt me një patogjen të panjohur, mund të përjetonim një katastrofë demografike.

Një pandemi si koronavirusi...

Shumë më keq. Kriza SARS-CoV-2 ishte serioze, por ne tashmë dinim shumë gjëra mbi koronaviruset. Ne i kemi hulumtuar ato për dekada me radhë dhe ia dolëm të reagojmë shumë shpejt me një vaksinë. Pandemia e fundit na tregoi se edhe forma të ndryshme të viruseve që ne tashmë i njohim, mund të shkaktojnë pandemi shumë serioze.

Këto forma mund të kenë ekzistuar në të kaluarën, dhe tani të rishfaqen. Por nëse virusi do të ishte plotësisht i panjohur, duhet t'ia nisim nga e para. Do të duheshin disa

vite për të prodhuar vaksina...

Ju jeni i sigurt se ka viruse të panjohura?

Po, dhe ne kemi gjetur tashmë disa të tillë.

Në fillim shkrimë një copë tokë që ka qenë në ngricë të përherëshme, dhe pastaj e pamë përmes mikroskopit. Vumë re amebat, qenie njëqelizore që mund të shihen lehtësisht. Shumë herë nuk ndodhi asgjë e rëndë, ndaj në ato mostra nuk kishte viruse. Por herë të tjera, pamë që amebat vdiqën, ndaj me siguri ato kanë pasur disa lloje virusesh që specializohen në sulmin e tyre për t'u riprodhuar. Ne i lamë të shumohen dhe i studiuam.

Pra në permafrost ka viruse të panjohura. A ka rreziqe nga shkrirja e tyre?

Në vitin 2016 në Siberi pati një epidemi të antraksit, e cila preku një komunitet barinjsh të zonës. Antraksi shkaktohet nga bakteret, por ato prodhojnë spore që të sëmurin. Dhe këto spore nuk janë aq të ndryshme nga viruset. Këto grimca inerte u riaktivizuan pasi ishin ngrirë për qindra ose mijëra vjet. Edhe viruset mund të riaktivizohen. Ato duhet vetëm të gjejnë bujtësin e tyre. Dhe ai nuk duhet të jetë një qenie njerëzore. Pandemia tjetër mund të vijë nga një virus që do të dalë nga toka e ngrirë e Arktikut, permafrosti.

Çfarë mund të bëhet për të reduktuar rreziqet?

Nëse dikush do të sëmuret rëndë në Siberi, me shumë mundësi do të dërgohet në Moskë. Në fakt ky është hapi më i gabuar, pasi pacienti duhet të trajtohet në terren, dhe kjo nënkupton sigurimin e atyre ambienteve me pajisje mjekësore kompetente, hapësira për izolimin e pacientëve, mjete për karantinë, trajnimin e mjekëve...Më e rëndësishmja është të ndërjegjësohen njerëzit se rreziku i tyre ekziston, pavarësisht sa i vogël mund të duket. Dhe duhet punuar me popullsinë lokale.

Permafrosti gjendet në një numër të vogël vendesh: Rusi, Shtetet e Bashkuara, Kanada, vendet skandinave... A është e njëjta gjë kudo?

Jo. Në Amerikën veriore dhe Grenlandë, ngrica e përherëshme është më shkëmbore dhe ka shumë pak jetë. Interesante për këto hetime është tipi Jedoma, i pasur me lëndë organike dhe që ndodhet në Siberi.

Ju keni një karrierë të gjatë ndërkombëtare. Si e nisët këtë punë?

Rastësisht. Po hulumtoja viruset gjigante që infektojnë amebat. Pastaj pashë një ekip rus që kishte arritur të rriste një bimë nga një farë, e cila kishte qenë nën akull për 30.000 vjet. Dhe thashë me vete: Pse të mos bëj të

njëjtën gjë me këto viruse?


A ka ndikuar situata politike në kërkimin tuaj?

Po, dhe është për të ardhur keq. Sepse s'mund të bëjmë kërkime të përbashkëta me shkencëtarët rusë. Fatmirësisht, ne kemi gjetur një mënyrë për ta bërë këtë falë Institutit Alfred Vagner në Potsdam, Gjermani.

Ata mblodhën mostra nga i ashtuquajtur i krateri i Batagaikas në vitin 2019, të cilat datojnë 650.000 vjet më parë, pra janë 10 herë më të vjetra nga mostrat që studiojmë zakonisht. Kjo e tejkalon datimin përmes karbonit, i cili arrin në 50.000 vjet dhe na detyron të përdorim teknika të reja. Ne po përgatitemi të punojmë me këto mostra, por duhet të jemi shumë të kujdesshëm për të shmangur ndotjen nga mikroorganizmat aktualë. Është një sfidë shkencore shumë e madhe.

Dhe cili ishte zbulimi juaj i fundit?

Nuk është publikuar ende, por kemi mundur të gjejmë viruse në fundin e Detit Ross në Antarktidë, në skajin tjetër të botës. Në këtë rast, kjo ndodhi falë një bashkëpunimi me shkencëtarët italianë që arritën të nxirrnin disa sedimente nga shtrati i detit në Antarktidë. Ato janë sërish viruse të amebave, të cilat sulmojnë këto organizma për t'u shumuar. Pra po zbulojmë se ky lloj virus gjendet absolutisht kudo.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

8 vjet nga pranimi i Kosovës në UEFA, Ademi: Aty filloi një epokë e re për FFK-në



PRISHTINË, 3 MAJ - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka kujtuar 8-vjetorin e anëtarësimit të Kosovës në UEFA. Ademi ka thënë se ky vendim i dha fund izolimit të padrejtë prej dy dekadash e gjysmë dhe se, sipas tij, kalimi i kësaj sfide nuk ishte i lehtë, por gjatë punimeve të Kongresit të 40 që u mbajt në Budapest, fitoi e drejta, fitoi Kosova. “Nga aty filloi një epokë e re për Federatën e Futbollit të Kosovës. Që nga ajo ditë zhvillimi e sukseset kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Klubet tona kanë demonstruar vlerat e tyre në arenën ndërkombëtare, duke na bërë krenarë me përfaqësimin dinjitoz. Niveli i ligës është rritur dukshëm

dhe jemi ndër kampionatet më të vlerësuara në rajonin tonë”, ka thënë Ademi. “Ekipet kombëtare janë konsoliduar, kanë bërë përparime të dukshme dhe janë në ndjekje të ëndrrës së madhe - kualifikimit në finalet e kometicioneve madhore. Një punë e madhe është bërë në krijimin e kuadrove të reja përmes UEFA-s për trajnerët, gjyqtarët e administratorët e futbollit. Me mbështetjen e programeve nga UEFA e FIFA kemi gjithëpërfshirje të komunitetit dhe futbollin e kemi shndërruar në aset kombëtar”, ka shtuar Ademi. Më tej, Ademi tha se që nga 3 maji i vitit 2016 energjia e re dhe dëshira për sukses e kanë shndërruar futbollin në një fuqi të

pasur me arritje dhe mundësi. “Sot ne festojmë këtë ditë me krenari dhe falënderim për të gjithë ata që kanë punuar e mbajtur gjallë futbollin që nga vitet e okupimit e deri në anëtarësimin tonë në UEFA, madje duke e sakrifikuar edhe pasurinë e familjeve të tyre. E tekta kujtojmë të kaluarën, jemi të përkushtuar për të ndërtuar një të ardhme më të ndritshme për futbollin kosovar. Si president i Federatës së Futbollit të Kosovës, bashkë me Komitetin Ekzekutiv, do të shtyjme para të gjitha proceset me besim e përkushtim që futbollin ynë të shkëlqejë në arenën vendore dhe atë ndërkombëtare”, ka deklaruar Ademi.

Sonte përcaktohet finalisti i dytë

PEJË, 3 MAJ - Sonte (e shtunë) nga ora 19:00 zhvillohet ndeshja e pestë dhe vendimtare në mes të Pejës dhe Golden Eagle Yllit. Skuadra që shënon fitore do t'i bashkohet Trepçës në finale të “play-off”-it. Seria gjysmëfinale është 2:2. Therandasi fituan dy ndeshjet e para, 84:87 dhe 92:86, por kampionët iu kundërpërgjigjën në dy sfidat e radhës, 98:86 dhe 80:81. Sfidat e së shtunës në Pejë do të vendosë për skuadrën që do të kualifikohet në finale. Pejanët kërkojnë finalen dhe ta mbrojnë titullin e kampionit, kurse therandasi për të depërtuar në finale dhe për ta rikthyer titullin e kampionit në Therandë. Takimi pritet të jetë shumë interesant, ashtu si kanë qenë katër gjysmëfinale të deritashme mes këtyre dy skuadrave.



SHKURT

Taekwondo i sjell edhe tri medalje të arta Kosovës nga Estonia

Pas suksesit që e treguan në Kampionatin Evropian të shteteve të vogla, taekwondistët tanë sërish kanë fituar medalje në dy gara të tjera ndërkombëtare, “Tallin Open G1” dhe “President Cup” që u mbajtën në Tallin të Estonisë. Në “Tallin Open G1”, në kategorinë deri në 54 kilogramë, Bleron Ademi e fitoi medaljen e artë për seniorë. Ndërkaq në “President Cup” shkëlqyen Mal Sahiti në kategorinë deri në 68 kilogramë dhe Jon Gashi në kategorinë deri në 73 kilogramë duke fituar medaljet e arta për juniorë. Në këtë garë, te seniorët, Bleron Ademi dhe Elion Agushi u renditën të pestët, duke treguar paraqitje tejet të mira. Të tre garuesit janë bursistë “Shpresa Olimpikë 2024”.

Kosova me gjashtë boksierë në Turneun Ndërkombëtar ‘Gongu i Artë’ në Shkup

Ekipi i Kosovës në boks do të marrë pjesë në turneun ndërkombëtar “Gongu i Artë”, i cili mbahet nga data 3 deri më 7 maj në Shkup. Kosova në këtë turne, ku pjesëmarrjen e kanë paralajmëruar 20 shtete, do të përfaqësohet me gjashtë boksierë: Bashkim Bajoku 57 kg, Luar Aliu, 57 kg, Lorent Murati, 60 kg, Shpëtim Bajoku 67 kg, Loris Idrizi 67 kg, Donat Sylja 92 kg. Trajnerë janë Musli Zymeri e Faton Xhakli, ndërsa gjyqtarë Latif Demolli e Marigona Beadini. Turneu është i mirëseardhur për vëllezërit Bajoku para kualifikimeve botërore në Bangkok të Tajlandës për normë të lojërave olimpikë “Parisi 2024”.

KV Drita fiton me përmbysje finalen e dytë ndaj Skenderajt

Akti i dytë i serisë së finaleve të “play-off”-it në Raiffeisen Superligën A të voleybollit te vajzat, ka sjellë edhe një dramë tjetër prej 5 setash, ku Drita fitoi 3 me 2. Gjithçka dukej se po shkonte mbarë për skuadrën nikoqire, kur Skenderaj e filloi në formë të shkëlqyer ndeshjen, pasi avancoi 2 me 0, pas dy seteve të parë të fituar 25:17 dhe 25:21. Mirëpo kampioni në fuqi dukej se kishte rezervuar befasi për pjesën e mbetur të ndeshjes. Drita solli një rikthim tjetër për mbamendje, kur i fitoi tri periudhat vijuese me rezultat 25:13; 25:22 dhe 15:11, për ta bërë edhe hapin e dytë drejt mbrojtjes së titullit.

Xhaka: Mund t'i shënonim më shumë gola Romës

Klubi i Granit Xhakës, Bayer Leverkuseni, ka arritur fitore të madhe në ndeshjen e parë gjysmëfinale në Ligën e Evropës ndaj Romës me rezultat 0-2. Mesfushori shqiptar Xhaka u shpreh i lumtur me paraqitjen e Leverkusenis, por është i mendimit se kanë mundur të shënojnë më shumë gola. “Rezultat i mirë, nuk pranuar gol, por mund të shënonim dy ose tre gola më shumë. Është normale të luajmë mençur qysh nga fillimi, pasi ne ishim mysafirë. Roma tentoi ta mbante topin, kurse ne jemi të mirë edhe kur nuk e mbizotërojmë topin”, ka thënë Xhaka, i cili më pas ka deklaruar se tash të gjithë ekipet dëshirojnë ta mposhtin Leverkusenin. “Jemi 47 ndeshje pa humbje, e dimë që të gjithë dëshirojnë ta na mposhtin neve tani. Ky mentalitet, ky kualitet që kemi edhe nga lojtarët që vijnë nga banka rezervë. Mund të shënojmë kundër çdo skuadre. Jam i lumtur që jam pjesë e kësaj skuadre”, ka deklaruar Xhaka.

Zyrtarizohet ekipi olimpik i refugjatëve, delegacioni me 36 sportistë nga 11 shtete

LOZANË, 3 MAJ - 36 sportistë nga 11 shtete të ndryshme do ta përfaqësojnë ekipin olimpik të refugjatëve të IOC, që do të marrë pjesë në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Ata do të garojnë në 12 disiplina sportive. Njoftimi u bë nga presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach, gjatë një ceremonie në

Lozanë. Kjo është hera e tretë në historinë e Lojërave Olimpikë që përfaqësohet edhe një ekip olimpik me refugjatë. Ekipi Olimpik i Refugjatëve do të përfaqësojë më shumë se 100 milionë njerëz të zhvendosur në mbarë botën. Përbërja e ekipit u miratua nga Komiteti Ekzekutiv i IOC dhe bazohet

në një sërë kriteresh. Kriteri kryesor ishte performanca sportive e çdo sportisti dhe statusin e tyre të refugjatit, siç verifikohet nga UNHCR, Refugjatët e Kombeve të Bashkuara. Për herë të parë Ekipi Olimpik i Refugjatëve do të garojë nën stemën e vet, një simbol unifikues që bashkon atletët të ndryshëm dhe i jep

ekipit identitetin e tij unik. Shumica e atletëve u përzgjedhën midis atletëve refugjatë të mbështetur nga IOC përmes Programit të Bursave për Atletët e Refugjatëve, i financuar nga programi i Solidaritetit Olimpik të IOC dhe i menaxhuar nga Fondacioni Olimpik i Refugjatëve.



Ballkani dhe Llapi presin fitoren e radhës

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Në fundjavë do të zhvillohet java e 32-të në Superligën e Kosovës në Futboll. Edhe pesë xhiro kanë mbetur deri në fund të sezonit, gara për titull vazhdon të jetë interesante. Gara për mbijetesë ka filluar të marrë fund për faktin se Liria i ka humbur zyrtarisht shanset që të mbetet pjesë e elitës, ndërsa afër është edhe Fushë-Kosova që luan ndaj Dritës. Gjilanasit kërkojnë fitore në këtë ndeshje, pasi tashmë ka mbetur katër pikë pas Ballkanit. Kampionët e Ballkanit e presin Dukagjinin me synim që t'i



ndalin tri pikët në Suharekë, por klubi nga Klina ka ditur shpesh të jetë i papërshtatshëm për klubet kryesuese.

Në "Zahir Pajaziti" të Podujevës, Llapi do të jetë nikoqir i Feronikelit 74. Llapjanët aktualisht gjenden në vendin e dytë me dy pikë më pak se Ballkani dhe me çdo kusht

kërkojnë fitoren për të vazhduar garën për titull, ndërsa Feronikeli 74 kërkon rezultat pozitiv për t'i ikur sa më shumë zonës së barazhit. Në duelet e tjera, Malisheva do ta presë Gjilanasit në "Liman Gegaj", kurse Prishtina i shkon Lirisë. Të gjitha ndeshjet zhvillohen të dielën dhe nisën nga ora 15:00.

SUPERLIGA

Ballkani - Dukagjini
Llapi - Feronikeli 74
Malisheva - Gjilana
Drita - Fushë Kosova
Liria - Prishtina

Indiana likuidon Milwaukeeen, mësohet çifti i parë gjysmëfinalist në NBA

Nju-Jork, 3 maj - NBA ka njohur çiftin e parë gjysmëfinalist në fazën "play-off". Indiana Pacers-New York do të duelojnë ndërmjet tyre për një biletë për në finalen e madhe në Lindje. Për herë të tretë radhazi, Milwaukee Bucks nuk ia del të shkojë në këtë fazë, ku vuajtën shumë mungesën e Antetokounmpos. Duhej një mrekulli nga ana e Milwaukeees për të qëndruar në lojë. I duhej të fitonte në fushën e Indianas për ta dërguar ndeshjen në serinë e 7, por një mrekulli e tillë nuk erdhi kurrë, pasi vendasit fituan 120-98 duke e dërguar në 4-2 serinë e fitoreve. Indiana udhëhoqi ndeshjen që në fillim, ndërsa gjysmën parë e mbylli me plus 12 pikë. 28 pikë e Lillardit nuk i



shërbyen për asgjë Milwaukeees. Një biletë për në gjysmëfinale siguroi edhe New York Knicksi duke mposhtur sërish Philadelphiaan, këtë herë 118-115, duke e dërguar në 4-2 serinë e

fitoreve. Ky kualifikim i New Yorkut kishte edhe më shumë shije pasi erdhi në transfertë. Brunsoni ishte protagonist absolut për New York edhe në këtë sfidë duke realizuar 41 pikë dhe 12 asistime.

SHKURT

Daku nominohet për lojtarin dhe sulmuesin e vitit në Rusi

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Mirlind Daku, ka shkëlqyer këtë sezon në Rusi me Rubin Kazanin. Futbollisti shqiptar u transferua në Rubin Kazan gjatë afatit veror nga skuadra e Osijekut për 1.2 milion euro. Gjatë këtij sezoni aktual ai ka shënuar 7 gola dhe ka bërë 4 asistime në 24 paraqitje. Daku është nominuar për disa çmime në kampionatin rus, si lojtari më i mirë i sezonit dhe sulmuesi më i mirë. Ai është nominuar për çmimin e debutuesit të vitit dhe për asistimin e vitit. Tifozët kanë të drejtën të votojnë nga data 2 maj deri më 13 maj, kurse pjesa tjetër varet nga votat e ekspertëve - të cilat fillojnë nga 15 maj deri më 24 maj. Kurse çmimet e më të mirit në Premier Ligë në Rusi do të ndahen më 26 maj.

Alonso: Ishte një paraqitje e madhe nga ana jonë

Bayer Leverkuseni nuk di të ndalet, bëjnë për "aspirina" Romën, duke vijuar rrugëtimin edhe në Evropë. Ekipi i Xabi Alonsos hedh një hap të sigurt drejt finales së madhe në Evropa Ligë, teksa thyen verdhekuqtë pastër 2-0 brenda në "Olimpico". Pas kësaj fitoreje të pastër, Alonso qëndron i qetë, por shpreson që të festojë me tifozët edhe në Gjermani. "Luftuan shumë, me forcë dhe disiplinë, por kemi ende shumë punë për të bërë. Ishte një paraqitje e madhe nga ana jonë. Luajtëm mirë në kundërsulm, por nuk arritëm të shfrytëzojmë rastet për të shënuar dhe golin e tretë, gjithsesi jemi të kënaqur. Shpresoj që të festojmë me tifozët tanë edhe javën e ardhshme", u shpreh Alonso.

De Rossi pas humbjes nga Leverkuseni: Kemi edhe ndeshjen e kthimit

AS Roma pësoi humbje në "Stadio Olimpico" nga Bayer Leverkusen (0-2). Pavarësisht kësaj, trajneri Daniele De Rossi, duket të jetë tejet optimist, teksa ka vendosur të mbajë lart moralin e skuadrës së tij dhe ka vendosur të gjithë fokusin e skuadrës, në sfidën e ardhshme që zhvillohet në "BayArena". "Kemi luajtur kundër një skuadre të fortë, e cila, nëse kalon në epërsi, të krijon vështirësi në menaxhimin e topit. Ecuria e përgjithshme u bë në mënyrë korrekte. Më pëlqeu pjesa e parë sepse e rikuperuam topin herët dhe i detyruam të hidhnin topa të gjatë. Ishte ajo që kishim përgatitur. Në ndeshjet e Evropës shumë herë e kemi zhbllokuar ndeshjen, por sot ndodhi e kundërta. Unë besoj shumë te kjo skuadër. Padyshim se do të jetë e vështirë, por nuk do të dorëzohemi", ka thënë De Rossi. "Episodet janë gjithmonë vendimtare, por do të ishte e padrejtë nëse sot do ta drejtonim gishtin për një gabim të bërë, kur ndoshta në ndeshjet e tjera fituam për gabimet e të tjerëve. Është pjesë e lojës. Të gjithë së bashku dalim nga kjo situatë. Kemi edhe një ndeshje kthimi. Në sekondën e fundit patëm një mundësi të jashtëzakonshme", ka shtuar De Rossi.

Ferrari 'vishet blu' për garën e Miamit

Në Formula 1 çështja Red Bull është ende në qendër të vëmendjes si për sukseset në pistë ashtu dhe atë që ndodh jashtë saj. Adrian Newey zyrtarizoi divorcin me Red Bull Racing në fund të sezonit, ndaj ka

nisur "gjuetia" për inxhinierin më të mirë në qarkullim. Gjeniu i makinave ka marrë mjaft oferta, por duket se Ferrari është në "pole" për ta sjellë në Maranello. Fillimisht ai është takuar me Frederic Vasseur, drejtorin sportiv

të "kokëkuqes", ndërkohë që nga Miami vijnë lëvdata për të nga dy pilotët e ardhshëm të Ferrari. "Në top-listën time të personave me të cilët dua të punoj është padyshim Newey. Shpresoj që vitin tjetër të jetë te Ferrari", ka

thënë Lewis Hamiltoni, 7 herë kampion bote. Piloti aktual i Mercedesit vitin tjetër do të garojë me makinën italiane, ndaj shpreson ta ketë në skuadër. Të njëjtën gjë ka thënë edhe Charles Leclerc, që shtoi: "Kemi një ekip

fantastik dhe fati që jemi makina që është përmirësuar më shumë në muajt e fundit e konfirmon këtë. Por, nëse ka një njeri që dua të punoj është padyshim Newey. Do të ishte fantastike ta kishim në ekip".



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT


SWISS TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Petrit Habibaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- Vjollca Habibaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi".
- Mehmet Haxhishabani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e Gjimnazit "Hajdar Dushi".
- Violeta Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Gani Haxha" (Haxhi Hoti).
- Enise Shuki shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Motrat Qjriazi " Prizren.
- Bejadin Dervishaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Jashar Krasniqi nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plot të shkollës fillore Kongresi i Manastirit Damjan KK Gjakovë.
- Astrit Tahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.
- Alban Meta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë prej klasës 1-8 të shkollës fillore "Selman Riza", Gjakovë.
- Fatlinda Gjuraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm të mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.
- Bekim Veljiji shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.
- Nexhmedin Tulla shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Lavdije Sopi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush Marku " Velezhe.
- Zylmi Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Edita Beqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Xhavit Januzi nga Nivokazi KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. Bujqësi " Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Fisnik Nixha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, Elektroteknik.
- Kingj Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. " Kadri Kusari" Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

